

*Draft*

**ANKETIM MBI PRIORITETET E REFORMËS ZGJEDHORE,  
SJELLJEN ELEKTORALE DHE SFIDAT E PËRFAQËSIMIT  
POLITIK NË SHQIPËRI**

*SURVEY ABOUT PRIORITIES OF THE ELECTORAL REFORM AND CHALLENGES OF POLITICAL  
PARTICIPATION IN ALBANIA*



Kingdom of the Netherlands



Ky botim bëhet në kuadër të projektit *“Partneritete të forta për reforma të qëndrueshme – Forcimi i rolit të shoqërisë civile në adresimin e sfidave të zgjedhjeve të lira dhe të drejta”*, mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta përmes programit MATRA.

*Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi vetëm e ekipit realizues të Institutit të Studimeve Politike dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e ambasadës.*

*Autor*

*Stafi i ISP në koordinimin e ekspertës  
Prof. Dorina Bërdufi*

ISBN xxxxx

*Të drejtat e autorit*

© Instituti i Studimeve Politike

Tiranë, 2024

## PËRMBAJTJA

1. HYRJE .....	4
2. GJETJET KRYESORE TË ANKETIMIT .....	7
3. KRAHASIMI I GJETJEVE 2023 - 2024.....	10
4. METODOLOGJIA.....	11
5. REFORMA ZGJEDHORE DHE PERCEPTIMI PËR PROBLEMATIKAT PRIORITARE .....	12
5.1. LIRIA PËR TË VOTUAR DHE ZGJEDHUR .....	12
5.2. ZGJEDHJET PRIORITARE? ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE DHE LOKALE.....	13
5.3. PËR ÇFARË DËSHIROJNË MË SHUMË INFORMACION QYTETARËT? .....	13
5.4 VLERËSIMI QYTETAR PËR SISTEMIN AKTUAL ZGJEDHOR / PËRFAQËSUES .....	15
6. PRIORITETET E REFORMËS ZGJEDHORE DHE TË PËRFAQËSIMIT .....	16
6.1 PRIORITETET E REFORMËS ZGJEDHORE 2025.....	17
6.2. PRIORITETET E REFORMËS NË LEGJISLACIONIN MBI PARTITË POLITIKE.....	19
6.3. KQZ, BESUESHMËRIA DHE REFORMA E MUNDSHME .....	21
6.4. LIDHUR ME SJELLJEN VOTUESE TË TË ANKETUARVE .....	23
7. PRIORITETET NË FUNKSION TË MANDATIT ZGJEDHOR 2025-2029 .....	24
8. VARIABLA TË PËRGJIGJEVE BAZUAR NË PUNËSIMIN DHE MOSHËN .....	26
8.1. LIRIA E VOTIMIT, SA MË TË VJETËR AQ MË TË KËNAQUR .....	26
8.2. VLERËSIMI I SISTEMIT ZGJEDHOR SIPAS GRUP MOSHAVE .....	27
8.3. NDIKIMI I MOSHËS NË PREFERENCËN POLITIKE.....	28
9. MBI VOTIMIN DHE NUMËRIMIN E ELEKTRONIK.....	31
9.1 MBI PËRVOJËN E VOTIMIT NË ZGJEDHJET VENDORE 2023 .....	31

## 1. HYRJE

Shqipëria po përgatitet të zhvillojë zgjedhjet pasuese parlamentare në fundin e pranverës së vitit 2025. Prej vitit 2020 nuk ka pasur ndërhyrje në Kodin Zgjedhor, ndërkohë që shumë prej rekomandimeve të ODIHR/OSBE-së për zgjedhjet e vitit 2019, 2021 dhe 2023 ende nuk janë adresuar. Gjatë këtyre viteve janë disa vendime të Gjykatës Kushtetuese që imponojnë ndërhyrje në Kodin Zgjedhor, përfshirë edhe ri përcaktimi i herësit dhe plotësimi i akteve ligjore për votën e diasporës. Një Komision i Posaçëm parlamentar për reformën zgjedhore i krijuar nga legjislatura aktuale parlamentare nuk arriti të ketë aktivitet normal dhe as vendimmarrje. Mosmarrëveshjet politike fillimisht për objektivin dhe kalendarin e punës dhe më pas për përbërjen politike të tij çuan në paralizimin e Komisionit dhe pas fillimit të vitit 2024, përfundimin e mandatit të tij pa dhënë rezultate.

Formula e Komisionit është zëvendësuar aktualisht nga një Grup i Dialogut në kuadër të Komisionit të Ligjeve në Kuvend, me përbërje të balancuar midis palëve politike, por me konflikte e mospërputhje midis partive përbërëse të opozitës. Ky grup nuk ka statusin e Komisionit të Posaçëm dhe nuk vepron mbi një kuadër ligjor funksional, të atillë që të sigurojë vendimmarrje efektive dhe as jetësimin e reformës. Produkti i tij ndërvarët nga vullneti politik i dy grupeve më të mëdha politike në parlament dhe ky “kusht” e bën grupin më të dobët institucionalisht, sesa praktika e mëparshme e Komisionit Ad-Hoc. Për më tepër, Komisioni kishte detyrimin e mbledhjeve, procedurës, produktit dhe raportimit në Kuvend, detyrime të cilat nuk vlejné në rastin e Grupit të Dialogut.

Pavarësisht debateve rreth mekanizmit që mund të shqyrtojë dhe adresojë çështjet prioritare të reformës, vetë reforma është e domosdoshme, është tema kryesore e diskursit politik dhe është një kriter i rëndësishëm për progresin e shtetit të së drejtës dhe demokracisë funksionale në Shqipëri. Bazuar në praktikën e Komisionit të Venecias, një reformë funksionale dhe solide do të duhet të bëhet një vit përpara datës së zgjedhjeve, periudhë kalendarike që tashmë është tejkaluar, por që mund të kompensohet, nëse Kuvendi vendos për ndërhyrje në legjislacionin zgjedhor brenda sesionit aktual parlamentar (qershor-korrik 2024). Kjo vlen sidomos për ndërhyrje të rëndësishme, siç janë: ndryshimet e pretenduara për sistemin zgjedhor, ndryshimet në legjislacion për jetësimin e votës së diasporës, mundësinë e aplikimit tërësor të votimit dhe numërimit elektronik apo depolitizimit të administrimit zgjedhor. Çështje të tjera mund të jenë objekt debati dhe vendimmarrje edhe në periudhën midis një viti deri në gjashtë muaj përpara zgjedhjeve.

Instituti i Studimeve Politike (ISP) ka monitoruar në vazhdimësi ecurinë e aktivitetit, vendimeve dhe propozimeve të ardhura nga partitë politike, Kuvendi dhe institucionet e tjera lidhur me tematikat zgjedhore. Në kuadër të projektit Cluster One, në nëntor 2023 ISP organizoi një tryezë debati me pjesëmarrjen e të gjitha palëve politike parlamentare dhe KQZ lidhur me prioritetet e reformës. Debati ishte konstruktiv, për më tepër kur zhvillohej në kushtet kur parlamenti nuk

ishite funksional dhe opozita ishte në protestë dhe bojkotim ndaj tij. Disa prej gjetjeve në këtë debat ishin të vlefshme dhe ofruan këndvështrime jo vetëm politike, por edhe profesionale lidhur me pritshmëritë, prioritetet dhe mundësitë reale të ndërhyrjes për reformën zgjedhore. Duhet thënë se disa prej deputetëve të përfshirë në debat dhe që bënin pjesë në Komisionin e Posaçëm për Reformën apo edhe aktualisht në Grupin e Dialogut, përveçse politikanë me përvojë, janë edhe ekspertë shumë të mirë të çështjeve zgjedhore, me eksperiencë të gjatë në reformat zgjedhore prej viteve 2000, - një tregues lehtësues për cilësinë e vendimmarrjeve të mundshme të tyre. Ky është edhe një tregues se politikanët ekspertë kanë sensibilitet më të madh për reformën sesa, liderët politikë jo ekspertë, dhe që kanë veton reale politike me impakt pozitiv ose negativ për jetësimin e reformës.

Në këto rrethana shoqëria civile është investuar në ruajtjen e urave të komunikimit midis palëve politike, sidomos midis politikanëve ekspertë, të cilët përfaqësojnë një spektër më të gjerë politik, si dhe adresimin e vazhdueshëm të rekomandimeve dhe të apelit për dialog konstruktiv. ISP, ASP dhe organizata të tjera të shoqërisë civile kanë adresuar pranë Komisionit të Posaçëm të Reformës rekomandime konkrete për çështje të ndryshme të reformës, që bëjnë pjesë në rekomandimet e ODIHR ose që i tejkalojnë ato, por ende Kuvendi nuk ka pasur një përgjigje zyrtare mbi rekomandimet e dërguara. Tryezat e debatit midis parlamentarëve, partive politike, faktorit ndërkombëtar dhe shoqërisë civile janë një rast i mirë adresimi dhe diskutimi.

Për këtë arsye ISP zhvilloi gjatë pranverës së vitit 2023 dhe asaj të 2024 një anketim kombëtar, në të cilin u përfshinë rreth 1 mijë shtetas me të drejtë vote nga 12 qarqet e vendit. Ideja e anketimit nuk ishte aspekti statistikor i të dhënave, por testimi i perceptimit dhe pritshmërisë publike mbi prioritetet e reformës dhe çështjet të cilat janë pjesë e diskursit politik dhe publik. ISP ka zhvilluar edhe intervista me ekspertë të fushës dhe ka monitoruar ligjërimin politik mbi reformën, të dhëna, të cilat në formë të kryqëzuar ndihmojnë në krijimin e një pasqyre me të plotë të perceptimit publik për prioritetet e reformës.

Anketimi i zhvilluar në prill 2024 me të njëjtën metodologji (në 12 qarqe, 980 pjesëmarrës, përgjigje anonime dhe të kategorizuara në aspekt gjeografik, nivel arsimor, nivel punësimi dhe nivel të ardhurash financiare), pati synim të njëjtë për të tërhequr perceptimet publike për debatet aktuale lidhur me sistemin tonë përfaqësues, reformën zgjedhore, reformën në legjislacionin mbi partitë politike dhe prioritetet për zgjidhje për t'u trajtuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025. Një anketim paralel me kontakt direkt me qytetarët në qarqet ku u testua votimi dhe numërimi elektronik në zgjedhjet vendore të vitit 2023, përfshiu pyetje specifike dhe teknike lidhur me votimin dhe numërimin elektronik, të dhënat e të cilit janë përfshirë në këtë raport si pjesë integrale e tij.

Në dallim nga viti 2023, ku fokus patën edhe problematikat e zgjedhjeve vendore, në vitin 2024 fokus kryesor patën propozimet e ndryshme të adresuara nga partitë politike për reformën zgjedhore në funksion të zgjedhjeve parlamentare. Anketimi u bë si pjesë e projektit *“Partneritete të forta për reforma të qëndrueshme – Forcimi i rolit të shoqërisë civile në*

*adresimin e sfidave të zgjedhjeve të lira dhe të drejta*”, mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta përmes programit MATRA, në realizimin e të cilit Instituti i Studimeve Politike (ISP) është në partneritet me Akademinë e Studimeve Politike (ASP).

Vlen të theksohet se ekziston një hendek midis diskursit politik për reformën dhe njohurive të thelluara qytetare për detajet e propozimeve për reformën dhe impaktin real të tyre, si dhe një lidhje gjithnjë e më e ndërvarur midis pozicionit politik të partive kryesore ndaj çështjeve kryesore të reformës me pozicionimin edhe të qytetarëve mbështetës të forcave të tilla politike. Sa më afër procesit zgjedhor, aq më shumë njësohen qëndrimet dhe preferencat politike edhe të qytetarëve, ndërkohë që pothuajse në të gjitha pyetjet kryesore ekziston një kategori e konsiderueshme votuesish të mundshëm që kanë paqartësi, mosbesim dhe neutralitet ndaj problematikave kryesore të reformës zgjedhore dhe reformës në përfaqësimin politik.

Nga ana tjetër, diskursi për reformën zgjedhore ka treguar se vetë aktorët politikë, përfshirë aktorë të rinj, më shumë konsumojnë ide dhe propozime kryesisht populiste, sesa kanë qasje strukturore, realiste dhe konstruktive ndaj reformës. Për shembull, mbledhja e 20 mijë nënshkrimeve për ndryshime të sistemit zgjedhor është një akt politik simbolik përballë faktit se ndryshimet në Kushtetutë nuk janë objekt i të njëjtës praktikë të inicimit të ligjeve të zakonshme. Ekzistojnë nisma të tilla të njëjta edhe nga grupe nga shoqëria civile, pa një qasje efektive dhe me pritshmëri minimale për të ndikuar realisht në debatin dhe vendimmarrjen mbi reformën zgjedhore. E njëjta kritikë vlen edhe për diskursin politik, sidomos nga palë politike që kanë mbështetje edhe nga institucionet ekzekutive, të cilat ndonëse marrin në konsideratë dhe deklarojnë angazhime (p.sh., vota e diasporës) *de-facto* e dinë se mungon regjistri dhe baza solide e jetësisimit të saj. Po ashtu, palë politike kryesisht të opozitës, të cilat adresojnë kërkesa, që ndonëse mund të jenë në interes të tyre elektorale, nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht interesin publik dhe mungon perceptimi qytetar mbi to (p.sh., çështja e koalicioneve).

Së fundi, anketimi nuk ka qëllime shteruese në debatin parlamentar, politik dhe publik për reformën, por vetëm nxitëse, sensibilizuese dhe ndihmuese për të krijuar një panoramë sa më aktuale të perceptimit publik dhe për ta adresuar këtë perceptim në institucione. Grupi i Dialogut dhe partitë parlamentare, KQZ dhe institucionet e tjera të lidhura me zgjedhjet, organizatat civile që kanë fokus zgjedhor dhe ekspertët e fushës, misionet ndërkombëtare në fushën e shtetit të së drejtës dhe zgjedhjeve janë përfituese direkt të gjetjeve të anketimit. Përmes marrjes, diskutimit dhe adresimit janë përfitues edhe qytetarët e përfshirë në anketim si dhe ata që presin standarde më të larta zgjedhore dhe përfaqësimi politik në Shqipëri. Kjo është edhe detyra klasike e shoqërisë civile.

Instituti i Studimeve Politike (ISP) falënderon qytetarët që u angazhuan, stafin mbështetës, donatorin që mundësoi realizimin e anketimit, partitë politike që treguan interes për gjetjet e anketimit dhe ekspertët e angazhuar, si dhe organizatat partnere në projekt dhe në debatin publik mbi reformën zgjedhore dhe reformën në legjisllacionin mbi partitë politike.

## 2. GJETJET KRYESORE TË ANKETIMIT

Materiali i plotë i të dhënave të anketimit ofron rezultate më të detajuara mbi perceptimin dhe pritshmëritë publike mbi sistemin aktual zgjedhor, sistemin përfaqësues, lirinë e votimit dhe problematikat e administrimit zgjedhor mbi sjelljen elektorale dhe përcaktimin e preferencave në dhënien e votës, si dhe mbi prioritetet e dëshiruara për pesë vitet e ardhshme. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet kryesore janë pasqyruar më poshtë:

### LIDHUR ME VLERËSIMIN E SISTEMIT AKTUAL ZGJEDHOR / PËRFAQËSUES

- 40% mendojnë se sistemi i bën deputetët të varur nga kryetari i partisë;
- 10% mendojnë se sistemi rrit konkurrencën midis kandidatëve për deputetë;
- 8% mendojnë se sistemi mundëson hyrjen e të rinjve në politikë;
- 7% mendojnë se sistemi i bën deputetët të varur nga donatorët financiarë;
- 4% mendojnë se sistemi na ka dhënë parlamentin që realisht duam.

### LIDHUR ME LIRINË PËR TË VOTUAR DHE PËR TË ZGJEDHUR

- 49% shprehen se ndjehen të lirë të votojnë dhe të zgjedhin;
- 50% shprehen se nuk ndjehen të lirë ose ndjehen pjesërisht të lirë .

### LIDHUR ME REFORMËN ZGJEDHORE DHE ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2025

- 72% pro vs 15% kundër kandidimit të politikanëve në hetime nga SPAK;
- 70% pro vs 8% për depolitizimin e plotë të administrimit zgjedhor;
- 70% pro vs 14% për aplikimin 100% të votimit dhe numërimit elektronik;
- 66% pro vs 18% për ndalimin e personave *non grata* si kandidatë në zgjedhje;
- 65% pro vs 8% për aplikimin 100% të listave të hapura në zgjedhjet 2025;
- 61% pro vs 8% për jetësimin e votës së diasporës (aty ku ata jetojnë);
- 60% pro vs 14% për më shumë kandidatë të pavarur/prurje të reja;
- 50% pro vs 18% për rikthimin e koalicioneve politike (formula para 2021);
- 48% pro vs 17% për financimin e partive vetëm sipas numrit të votave;
- 46% pro vs 16% për heqjen e pragut zgjedhor për partitë / kandidatët;
- 29% pro vs 45% për vendosjen e votimit të detyrueshëm mbi 18 vjeç.

### LIDHUR ME REFORMËN NË LEGJISLACIONIN MBI PARTITË POLITIKE

- 74% pro vs 9% për ndalimin e financimit kriminal/informal të partive;
- 68% pro vs 13% për kufizimin e mandatit të kryetarëve të partive;
- 64% pro vs 12% për detyrimin e partive për zgjedhje të brendshme periodike;
- 53% pro vs 15% për ndalimin e financimit të partive nga jashtë vendit;
- 51% pro vs 19% për krijimin e partive të reja për pluralitet konkurrues;
- 45% pro vs 18% për shkrirjen e partive që marrin më pak se 3 mijë vota;

- 44% pro vs 22% për lejimin e partive që krijohen jashtë vendit;
- 43% pro vs 18% për heqjen e mbështetjes shtetërore për seli falas të partive;
- 37% pro vs 33% për lejimin dhe konkurrimin e partive lokale;
- 37% pro vs 48% për lejimin e krijimit të partive mbi baza etnike;
- 14% pro vs 61% për lejimin e partive fetare mbi baza / identitet fetar.

#### RËNDËSIA E ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE VS ZGJEDHJET LOKALE

- 70% i vlerësojnë njësoj të rëndësishme, zgjedhjet parlamentare e lokale;
- 13% i vlerësojnë më të rëndësishme zgjedhjet parlamentare.

#### LIDHUR ME ROLIN DHE PËRGJEGJËSINË E ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR (KQZ)

- 24% pro vs 48% që KQZ garanton besueshmëri për zgjedhjet;
- 53% pro vs 20% që KQZ është i kontrolluar nga partitë politike;
- 33% pro vs 38% që KQZ të shkrihet, përgjegjësia e zgjedhjeve t'i kalojë qeverisë;
- 61% pro vs 14% për riorganizimin e KQZ, organ përgjegjës të bëhet Komisioneri.

#### INFORMIMI I ZGJEDHËSVE: ÇFARË INFORMACIONI U MUNGON?

- 45% duan më shumë informacion për partitë/kandidatët në votim;
- 21% duan informacion për mënyrën e denoncimit të rasteve abuzive;
- 15% duan informacion për mënyrën e numërimit të votave.

#### LIDHUR ME PREFERENCA POLITIKE SI VOTUES: KUR MERRET VENDIMI PËR VOTËN

- 41% e qytetarëve e kanë gjithnjë të qartë se për kë do të votojnë;
- 22% e krijojnë bindjen e votës gjatë fushatës elektorale;
- 17% e krijojnë bindjen e votimit përpara fushatës zgjedhore;
- 9% vendosin të votojnë në konsultim me familjen;
- 6% e krijojnë bindjen e votimit ditën e zgjedhjeve.

#### LIDHUR ME PRIORITETET KRYESORE QË DUHEN ZGJIDHUR 5 VITET E ARDHSHME

##### Prioriteti I

- 56% modernizimi i sistemit arsimor;
- 55% dekriminalizimi i politikës;
- 50% lufta ndaj korrupsionit;
- 49% forcimi i shtetit të së drejtës;
- 47% dobësimi i oligarkëve/ulja e kriminalitetit.

##### Prioriteti II



- 32% reduktimi i emigracionit;
- 28% forcimi i mirëqeverisjes;
- 28% reduktimi i varfërisë;
- 27% ulja e papunësisë.

#### Prioriteti III

- 17% rritja e kulturës qytetare;
- 17% fokusimi tek anëtarësimi në BE;
- 16% investimet në infrastrukturë;
- 15% forcimi i shtresës së mesme.

#### Prioriteti IV

- 22% investimet në infrastrukturë;
- 13% fokusimi tek anëtarësimi në BE;
- 11% zhvillimi i turizmit.

#### Prioriteti V

- 31% investimi në mbrojtje / siguri;
- 28% zhvillimi i turizmit;
- 22% fokusimi tek anëtarësimi në BE.

### 3. KRAHASIMI I GJETJEVE 2023 - 2024

ISP zhvilloi anketime të njëjta edhe në të njëjtën periudhë të vitit 2023, kur klima politike ishte më e ndërthurur me klimën elektorale të zgjedhjeve vendore të majit 2023 dhe impaktit të tyre në zhvillimet politike në vend. Në periudhën aktuale nuk ka diskurs të rënduar politik në debatin për reformën dhe as proces të afërt zgjedhor, ndaj qytetarët e anketuar nuk kanë ndonjë presion direkt apo indirekt në dhënien e përgjigjeve ose krijimin e një bindjeje emocionale.

Nga ana tjetër, vetë qytetarët, sidomos ata që janë mbështetës të partive politike, kanë prirjen të lëvizin bindjet e tyre në varësi nga pozicioni politik që mban partia e tyre politike. Kjo shpjegon se përse disa çështje që kishin mbështetje maksimale në vitin 2023 kanë mbështetje më të paktë më 2024, ndërkohë që është rritur numri i qytetarëve që kanë qëndrime neutrale apo nuk kanë një qartësi në shprehjen e opinionit dhe preferencave të tyre.

	2023	2024
Pro votimit dhe numërimit elektronik	96%	70%
Pro votës së diasporës në zgjedhje	90%	61%
Pro hapjes 100% të listave të kandidatëve	89%	65%
Pro zgjerimit me kandidatë të pavarur / parti të reja	84%	60%
Pro uljes / heqjes së pragut zgjedhor	79%	46%
Pro financimit të partive mbi bazën e numrit të votave	76%	48%
Pro detyrimit për zgjedhje të brendshme tek partitë	79%	64%
Mbështetje e KQZ si institucion i pavarur	44%	24%
Mungesë informacioni mbi mënyrën e denoncimeve	22%	21%
Mungesë informacioni mbi mënyrën e numërimit	24%	15%
Zgjedhjet parlamentare e lokale janë njësoj të rëndësishme	56%	70%
Qytetarët nuk janë të lirë të votojnë / zgjedhin	23%	50%
Bindja e votimit është krijuar para fushatës	65%	17%
Bindja e votimit krijohet gjatë fushatës	28%	22%
Bindja e votimit krijohet në momentin e fundit	21%	6%
Bindja e votimit përcaktohet nga familja	13%	9%
Mosha e tretë voton pa ndryshim bindjeje	60%	60%
Bindja e votimit është e pandryshuar gjithnjë	40%	41%
Prioritet kryesor është varfëria, papunësia	62%	50%

Tabela 1\_Krahasimi i gjetjeve 2023 - 2024

#### 4. METODOLOGJIA

Periudha e realizimit të anketimit u shtri në dy javët e dyta të muajit prill 2024 dhe u zhvillua *online* mbi bazën e përfaqësimit të 12 qarqeve, si dhe klasifikimit paraprak mbi bazën e gjinisë, arsimimit, profesionit, punësimit dhe të ardhurave personale. Preferencat politike nuk ishin pjesë e anketimit dhe garantimi i anonimitetit ndihmoi në dhënien e përgjigjeve pa ndikime nga diskursi politik ditor.

Në muajin mars 2024 u zhvillua edhe një pyetësor në formatin letër (paper-based) ballë për ballë, ku u përfshinë vetëm pyetjet lidhur me përdorimin e teknologjisë në zgjedhje (votimi dhe numërimi elektronik). Gjetjet e të dy pyetësorëve janë pasqyruar në këtë material analitik.

Kampioni në nivel kombëtar është hartuar të jetë statistikisht përfaqësues, me një numër prej 980 dhe me një marzh gabimi të pritshëm  $\pm 3.1\%$ , me shpërndarje në 12 qarqe. Në ndërtimin e kampionit janë përdorur statistikat zyrtare të KQZ dhe të INSTAT. Përpunimi i të dhënave u realizua me anë të programit statistikor SPSS nga ekspertja e metodave të kërkimit, Prof. Dorina Bërdufi.

## 5. REFORMA ZGJEDHORE DHE PERCEPTIMI PËR PROBLEMATIKAT PRIORITARE

Komisioni i Posaçëm parlamentar për Reformën Zgjedhore e mbylli mandatin pa arritur të jetësojë ndryshime në legjislacionin zgjedhor, produkt parlamentar dhe ligjor dhe as dakordësi lidhur me çështjet kryesore që kanë të bëjnë me reformën zgjedhore apo rekomandimet periodike të ODIHR/OSBE. Me mbarimin e mandatit, parlamenti “krijoi” një mekanizëm të ri të dialogut politik, grupin politik të përbërë nga gjashtë deputetë, 3 nga PS / PSD dhe 3 nga PD / PL.

### 5.1. LIRIA PËR TË VOTUAR DHE ZGJEDHUR

Shqipëria ushtron të drejtën e votës pluraliste prej vitit 1991, duke zhvilluar më shumë se 20 procese elektorale parlamentare, lokale, referendume ose zgjedhje të pjesshme. Kushtetuta ofron garanti të lirisë së votimit dhe qeverisja bazohet te parimi i zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Liria e votës është themeli i demokracisë. Cënimi i saj në forma të ndryshme përbën problem tepër serioz për një shoqëri që synon demokracinë funksionale. Kjo përvojë dhe këto parime do të ishin të mjaftueshme për të krijuar një bazë solide të besimit tek institucioni i zgjedhjeve dhe cilësia e tyre.

Si është perceptimi publik mbi pyetjen “a janë qytetarët shqiptarë të lirë të votojnë / zgjedhin si të duan?”

Rezultati është shqetësues për një vend me tri dekada tranzicion dhe me synim anëtarësimin në BE. Vetëm gjysma e elektoratit pohojnë lirinë për të zgjedhur kandidatin / partinë që duan, një e treta mendojnë që kjo liri është e pjesshme dhe pothuaj 1/5 e tyre pohojnë mungesë lirie në votim. Në total dy kategoritë “pjesërisht” dhe “jo” përbëjnë gjysmën e elektoratit, një tregues kritik dhe pasqyrë e mungesës së plotë ose të pjesshme të besimit tek integriteti i votimit dhe vota si akt i lirë dhe e drejtë kushtetuese në një vend demokratik.




Tabela 2\_Liria për të votuar dhe zgjedhur

## 5.2. ZGJEDHJET PRIORITARE? ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE DHE LOKALE

Në traditën politike për sa i përket qasjes së votuesve, pjesëmarrja në zgjedhjet parlamentare është më e lartë në krahasim me ato lokale, si dhe me zgjedhjet europiane në rastin e vendeve të BE-së. Pushteti vendor është kompleks në përfaqësim, kompetencat midis kryetarëve të bashkive dhe këshillave, si dhe vetë fushata me fokus lokal nuk e kanë fuqinë mobilizuese të njëjtë me konkurrencën politike në nivel kombëtar për të zgjedhur alternativën më të mirë për qeverisjen e vendit dhe përmes saj, kryeministrin dhe qeverinë e re. Anketimi i kryer nga ISP tregoi tendencën se dy zgjedhjet (parlamentare dhe lokale) janë po aq të rëndësishme.

Konkretisht, në pyetjen se për cilat zgjedhje janë më tepër të interesuar në përgjithësi, rezultati tregon koherencë me pjesëmarrjen e votuesve në zgjedhjet në Shqipëri (tendenca e përgjithshme është pjesëmarrje më e lartë në zgjedhjet parlamentare, sesa ato lokale), pasi interesi për zgjedhjet parlamentare rezulton të jetë 3% më i lartë se në zgjedhjet lokale. Ndërkohë, sikurse edhe pritej, qytetarët shqiptarë në masën 70% janë të interesuar për të dy tipet e formave të zgjedhjeve dhe vetëm 8% nuk janë të interesuar në asnjërën prej formave të zgjedhjeve.




Tabela 3\_Zgjedhjet prioritare: zgjedhjet parlamentare vs zgjedhjet lokale

## 5.3. PËR ÇFARË DËSHIROJNË MË SHUMË INFORMACION QYTETARËT?

Procesi zgjedhor përfshin një sërë elementesh teknikë, politikë, ligjorë, formalë dhe përmbajtësorë. Legjislacioni përcakton mënyrat se si realizohet informimi i qytetarëve, formën / përmbajtjen e fletës së votimit, vendndodhjen e qendrës së votimit, mënyrën e votimit, mënyrën e numërimit të votave, mënyrën e denoncimit të rasteve abuzive apo informimin mbi partitë / koalicionet dhe kandidatët konkurrues në zgjedhje. Informimi i qytetarëve është

detyrim ligjor dhe realizohet nga KQZ dhe bashkitë respektive, përgjegjësitë e tjera ndahen midis një numri të madh institucionesh dhe mekanizmash, përfshirë edhe vetë strukturën e administrimit zgjedhor.

Sistemi zgjedhor proporcional rajonal aplikohet prej vitit 2008, pra ka përvojë të gjatë dhe me të janë zhvilluar katër zgjedhjet parlamentare të viteve 2009, 2013, 2017, 2021. Kjo nënkupton se qytetarët janë të familjarizuar me sistemin e votimit (mënyrën e votimit). Ndryshimet që ndodhën në zgjedhjet e vitit 2021 (vota pjesërisht preferenciale dhe ndalimi i koalicioneve) në thelbin e tyre nuk e cenojnë mënyrën e votimit dhe as sistemin e testuar në katër proceset zgjedhore parlamentare.




Tabela 4\_Kërkesa për informacion

Partitë deklarojnë se vota për ta / kundër tyre bazohet në qëndrimin e elektoratit ndaj kandidatëve dhe programeve të tyre elektorale, duke supozuar se partia fituese ka kandidatët më të mirë dhe programin elektoral më efektiv. Megjithatë perceptimi publik është tjetër. Pyetjes se cilat janë nevojat e qytetarëve për më shumë informacion zgjedhor, gjysma e tyre i janë përgjigjur dukshëm në favor të nevojës për informacion më të thellë për kandidatët dhe partitë (subjektet zgjedhore). Kategoria e dytë e nevojës për informacion është interesante dhe surprizuese, sepse ka të bëjë me mënyrën e denoncimit të rasteve abuzive (21%). Fakti se kjo kategori përbën të dytën më të votuar, do të thotë se interesi qytetar për të denoncuar ka qenë shumë i lartë, por edhe se ka pasur një nivel të lartë të rasteve që meritojnë denoncim. Mënyra e numërimit të votave merr kuotë gjithashtu të lartë (15%), kategoritë e tjera janë më minore në përzgjedhje.

Të dhënat e kësaj tablele janë të rëndësishme dhe me vlerë adresimi sidomos tek partitë politike konkurruese në zgjedhje dhe tek KQZ, si organ me përgjegjësinë e informimit publik mbi zgjedhjet dhe administrimin e tyre.

#### 5.4 VLERËSIMI QYTETAR PËR SISTEMIN AKTUAL ZGJEDHOR / PËRFAQËSUES

Sistemi aktual zgjedhor është përcaktuar me ndryshimet kushtetuese të vitit 2008 (me konsensus midis PS-së dhe PD-së) dhe ato të vitit 2020 (pa konsensus politik, me votat e PS-së). Pavarësisht se nga viti 2008 janë zhvilluar disa procese zgjedhore (2009, 2013, 2027, 2021), zërat kritikë ndaj sistemit kanë ardhur në rritje.




Tabela 5\_ Vlerësimi qytetar për sistemin aktual zgjedhor / përfaqësues

Premtimi se sistemi i ri do të krijonte sistem më efektiv përfaqësues, cilësi përfaqësimi dhe “elita” politike në parlament, nuk u mbajt. Legjislaturat vijuese kanë shfaqur rënie të cilësisë së përfaqësimit, rënie të besueshmërisë dhe mbështetjes publike ndaj parlamentit dhe dobësim të institucionit të deputetit si individ brenda grupeve parlamentare dhe në kuadër të Kuvendit.

Qytetarët u ftuan të shprehen për disa nga vlerësimet më të njohura lidhur me sistemin aktual zgjedhor dhe përfaqësues. Kuotat më të larta i mori vlerësimi se sistemi aktual “i bën deputetët të varur nga kryetari i partisë”, shifër katër herë më e lartë, sesa alternativa e dytë më e votuar, se sistemi aktual përfaqësues rrit konkurrencën midis kandidatëve për deputetë.

Perceptimi i përgjithshëm për nivele të larta të autoritarizmit të kryetarit të partisë nga ana e votuesve plotësohet edhe me elementët e tjerë, përfshirë ndikimi i varësisë nga donatorët / financuesit elektorale (7%), dhe pranimi në 5-7% se cilësia aktuale e parlamentit është më e mirë, apo se sistemi mundëson zgjedhjen e deputetit që duam.

Karakteristika të tjera të cilat janë pozitive për një vend demokratik janë vlerësuar me nivele të ulëta, si p.sh.,

- vetëm 4% besojnë se sistemi i detyron deputetët të jenë transparentë / llogaridhënës,
- vetëm 6% besojnë se sistemi i jep vlerë meritokracisë dhe aftësisë në politikë,
- vetëm 5% mendojnë se sistemi lidh më shumë qytetarin me Kuvendin / vendimmarrjen.

Ndërkohë, 8% mendojnë se sistemi aktual mundëson hyrjen e të rinjve në politikë, dukuri që u shfaq edhe në zgjedhjet e fundit, duke shënuar disa prurje të reja surprizë, por jo domosdoshmërisht cilësi më të lartë parlamentare. Në konkluzion, mund të arrihet në përfundimin se qytetarët janë kritikë në vlerësimin e sistemit aktual elektorale në parametrat e një sistemi zgjedhor efektiv dhe demokratik.

## 6. PRIORITETET E REFORMËS ZGJEDHORE DHE TË PËRFAQËSIMIT

Në anketim u përfshinë tri paketa pyetjesh që lidhen me reformën zgjedhore, me reformën në legjislacionin mbi partitë politike dhe me administrimin zgjedhor (kryesisht KQZ). Qëllimi ishte marrja e perceptimit publik për tematika aktuale që janë edhe në interes të publikut dhe të Kuvendit në procesin e diskutimeve për ndërhyrje ose përmirësime në kuadër të reformës zgjedhore.

Të dhënat e pasqyruara në tabela reflektojnë përgjigjet në dy kategori (konfirmuese ose refuzuese), duke lënë jashtë tyre përqindjet e qytetarëve që nuk kanë pasur qëndrim ose kanë pasur qëndrim neutral. Megjithatë në të dhënat fundore të anketimit, në përqindje janë pasqyruar të gjitha përgjigjet e detajuara.



## 6.1 PRIORITETET E REFORMËS ZGJEDHORE 2025

Pjesa më e rëndësishme e anketimit lidhet me perceptimin publik për debatet aktuale rreth reformës zgjedhore dhe alternativat për rrugëzgjdhje të qëndrueshme dhe efektive. Nga të dhënat e anketimit rezulton qartazi se ka mbështetje të lartë për shumicën e ideve dhe propozimeve që janë artikuluar aktualisht nga aktorë të ndryshëm politikë dhe civilë mbi reformën zgjedhore.

Konkretisht,

- **Më shumë se dy të tretat (70%) mbështesin votimin dhe numërimin elektronik** në të gjithë vendin, vs vetëm 20% kundër. Kjo mbështetje supozohet se bazohet në përvojën pozitive në 3 bashkitë ku u eksperimentua gjatë zgjedhjeve të fundit vendore, por edhe në pritshmërinë publike për nxjerrjen e shpejtë të rezultatit të zgjedhjeve dhe nivelin e lartë të mosbesimit tek komisionerët e emëruar nga partitë politike. Besimi tek teknologjia më shumë sesa tek njeriu, në një vend në tranzicion si Shqipëria, është më shumë tregues i nevojës për dalje nga rrethi vicioz, sesa tregues moderniteti.
- Në nivele të njëjta pro dhe kundër është edhe **mbështetja për depolitizimin e plotë të administrimit zgjedhor (KZAZ / KQV, GN)**, si dhe mbështetja e nevojës që të ketë më shumë hapësirë për kandidatë të pavarur dhe parti të reja politike.
- **Dy të tretat (65%) mbështesin propozimin për aplikimin në zgjedhjet parlamentare të listave 100% të hapura**, ndaj 25% që janë kundër. Nga kryqëzimi i të dhënave në përgjigjet e anketimit nuk rezulton se qytetarët kanë informacion të plotë dhe të detajuar mbi sistemet zgjedhore, megjithatë ata më shumë i besojnë zgjedhjes nga qytetari sesa zgjedhjeve të pjesshme, të kushtëzuara nga formula aktuale e kandidimit.
- **Në shifër të përafërt (60% pro dhe 27% kundër) mbështetet edhe nisma për jetësimin e votës së diasporës në vendet ku qytetarët me të drejtë vote banojnë / jetojnë**, pra në vendet përkatëse të rezidencës aktuale. Shifra është e lartë, por gjithsesi më e ulët sesa ajo e një viti më parë, tregues që ne e shpjegojmë me faktin se me pozicionin politik të partive politike dhe skepticizmin e partive kryesore edhe qytetarët mbështetës të tyre kanë ndryshuar sjelljen, duke ia afruar atë më shumë partisë së preferuar.




Tabela 6\_Prioritetet e reformës zgjedhore 2025

Disa të dhëna të tjera janë gjithashtu të rëndësishme në kuadrin e debatit për reformën aktuale zgjedhore. Për shembull:

- **46% mendojnë se duhet të hiqet pragu zgjedhor** për të mundësuar më shumë përfaqësim, ndaj 37% që janë kundër;
- **47% mendojnë se partitë politike të marrin financim vetëm sipas numrit të votave** që kanë marrë në zgjedhjet paraardhëse (e mëparshme), ndaj 34% që janë kundër;
- si dhe **vetëm gjysma (50%) janë dakord me nismën e rikthimit të formulës që lejon konkurrimin me koalicione politike** në zgjedhjet parlamentare, ndaj 30% që janë kundër.

Në kuadër të debatit për integritetin e kandidatëve, të partive dhe të parlamentit, si dhe të monitorimit që ISP i bën kësaj problematike prej disa vitesh, në anketim u shtuan edhe dy pyetje lidhur me specifikat aktuale të dekriminalizimit dhe shpalljes “*non grata*”. Nga të dhënat rezultojnë se:

- **72% e qytetarëve** të përfshirë në anketim janë dakord me vlerësimin se politikanët në **hetime zyrtare nga SPAK të mos kandidojnë** në zgjedhjet parlamentare, ndaj 12% që janë kundër;
- **66% e qytetarëve** në anketim janë dakord me shprehjen se **personat e shpallur NON GRATA** të mos jenë kandidatë në zgjedhjet parlamentare, ndaj 15% që janë kundër.

Interesante janë shifrat jo **tepër të larta të refuzimit të votimit të detyrueshëm me ligj** për qytetarët mbi 18 vjeç në masën 45% (pak + aspak), ndërsa ata të cilët e mbështesin këtë ndryshim janë vetëm 34%.

## 6.2. PRIORITETET E REFORMËS NË LEGJISLACIONIN MBI PARTITË POLITIKE

Këshilli Politik (2020) u dakordësua për të pasur reformë edhe në legjislacionin mbi partitë politike krahas reformës zgjedhore. Nga përvoja shqiptare dhe më tej asnjë reformë zgjedhore nuk mund të ketë sukses, nëse nuk reflekton ndryshime dhe qasje cilësore edhe në mënyrën e organizimit, funksionimit, financimit dhe veprimit të partive politike, të cilat kanë monopolin e propozimit të kandidatëve, të organizimit dhe zhvillimit të fushatës elektorale dhe të administrimit zgjedhor. Pavarësisht se nga viti 2020 nuk ka pasur ndryshime cilësore në këtë drejtim, ISP e konsideroi të rëndësishme trajtimin e kësaj problematike dhe asistimin e debatit publik me perceptimet e qytetarëve mbi elementë të rëndësishëm të reformës mbi partitë politike dhe legjislacionin për to.

Lidhur me debatin e demokracisë së brendshme në partitë politike, rolin e partive dhe përgjegjësinë shtetërore në “ushqimin” e sistemit të partive politike përgjigjet pasqyrojnë trendin kritik të qytetarëve dhe kërkesa të qarta për reformim.

Lidhur me partitë politike: sa jeni dakord me disa propozime?




Tabela 7\_Prioritetet e reformës në legjislacionin mbi partitë politike

Konkretisht:

- **64% e qytetarëve mendojnë se partitë politike duhet të detyrohen me ligj për të zhvilluar konceptet e demokracisë së brendshme të tyre, pra zgjedhjet dhe vendimmarrjet, ndaj vetëm 11% që janë kundër;**
- **58% mendojnë se kryetarët e partive politike duhet të kenë mandate të kufizuara drejtimi, ndaj 13% që janë kundër;**
- **53% e qytetarëve janë dakord me ndalimin e financimit të partive politike nga jashtë shtetit (nënkuptuar shtetet e tjera), ndaj 15% që janë kundër;**
- **42% mendojnë se shteti nuk duhet të pajisë partitë parlamentare me seli falas, duke i detyruar ato që të përdorin fondet shtetërore periodike për funksionet e tilla organizative, ndaj 18% që janë kundër.**

Një pjesë tjetër e pyetjeve lidhet me specifika të legjislacionit shqiptar (ndalimin e partive mbi bazë etnike, *de facto* ndalimin edhe të partive lokale apo fetare, etj.). Të dhënat janë me interes sepse lidhen me sfidat dhe pritshmëritë që mund të ketë evoluimi i sistemit partiak në Shqipëri në kohën kur tendencat etnike, fetare dhe lokale janë tipare të partive politike edhe në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe më tej.

Nga të dhënat e anketimit rezulton se:

- **Dukshëm partitë me baza etnike dhe fetare nuk përbëjnë faktor nxitës** me mbështetje publike në ndryshimet e mundshme të reformës elektorale (dakordësia për lejimin e këtyre partive është përkatësisht 22% dhe 14% dhe mosdakordësi shumëfish më e lartë, përkatësisht 48% dhe 61%);
- Më ndryshe paraqitet situata me **lejimin e konkurrimit të partive lokale**, ide e cila mbështetet në 37% dhe nuk mbështetet nga 23%;
- Alternativa e nxitjes së krijimit të partive të reja politike për të pasur një pluralizëm më konkurrues dhe lejimin e krijimit të partive në diasporë (kjo e fundit aktualisht e ndaluar nga ligji), kanë nivel thuajse të afërt në mbështetje e refuzim, përkatësisht 51% dhe 44% pro dhe në masën 19% dhe 23% kundër. Këto rezultate janë tregues të një votuesi që është deri diku i përfshirë (ndikuar) në diskursin aktual të medias dhe gjithashtu shfaq kërkesa për pluralizëm konkurrues.

### 6.3. KQZ, BESUESHMËRIA DHE REFORMA E MUNDSHME

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ligjërisht është institucioni përgjegjës për garantimin e besueshmërisë së plotë në procesin dhe rezultatet zgjedhore, institucion zyrtarisht i pavarur nga partitë politike dhe qeveria. I përbërë nga tri struktura të zgjedhura nga Kuvendi, KQZ

reflekton balancimin politik preferencial (Komisioneri dhe zv/ Komisioneri, si dhe Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS)).

Nga zgjedhjet e fundit lokale dhe parlamentare është konstatuar diferenca e dukshme në vendimmarrje të rëndësishme për të njëjtat dispozita ligjore midis Komisionerit Shtetëror dhe KAS, si dhe disa kontraste në funksionim, vendimmarrje dhe legjitimitetin e përfaqësimit ndaj palëve të treta, publikut dhe Kuvendit.

Për këto arsye ISP përfshiu KQZ-në në disa pyetje që kanë të bëjnë me besueshmërinë publike, por edhe me reformën e mundshme në procesin e administrimit qendror zgjedhor.

Në pyetjen e realizuar me qëllim për të matur këto detyrime ligjore të KQZ rezultatet tregojnë perceptim aktual jo shumë pozitiv ndaj veprimitarisë së këtij institucioni.




Tabela 8\_KQZ, besueshmëria dhe reforma e mundshme

- Vetëm 25% e qytetarëve në anketim tregojnë nivele të konsiderueshme të besimit te KQZ si institucion i cili garanton besueshmëri për zgjedhjet ndaj rreth dyfishi kundër;
- 53% duket se e thellojnë arsyetimin e parë duke vlerësuar se KQZ është i kontrolluar nga partitë politike;
- 58% mendojnë se KQZ duhet riorganizuar dhe përgjegjësia për zgjedhjet t'i kalojë një strukture të vetme, Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet;
- Si dhe ka një balancë në vlerësimin se KQZ duhet shkrirë dhe përgjegjësia për zgjedhjet t'i kalojë qeverisë (33% pro dhe 38% janë kundër).

## 6.4. LIDHUR ME SJELLJEN VOTUESE TË QYTETARËVE

Tabela që analizon sjelljen votuese, kryesisht të brezit të ri, konfirmon dominimin e kulturës politike, sipas të cilës, votuesit janë në shumicën e tyre të paracaktuar, pra kanë bindje të përhershme dhe të qëndrueshme për partinë e tyre politike pavarësisht ofertës programore ose kandidatëve të saj në zgjedhje. Kjo sjellje ka shfaqje të dy tipareve kryesore ideologjike (pra mbështetje të partisë politike në kohë) dhe pragmatiste (mbështetje e partisë për interesa racionalë). Interesante është që në të dy rastet votuesi shqiptar ka tendencë që vendimin se për kë do të votojë e merr herët në kohë (përpara zgjedhjeve).




Tabela 9\_Sjellja votuese e të anketuarve

Konkretisht:

- **41% e të anketuarve deklarojnë se e kanë të përcaktuar / të qartë paraprakisht** se për cilën parti politike do të votojnë, pavarësisht fushatës dhe periudhës zgjedhore. Këta konsiderohen votues të qëndrueshëm mbështetës të partive politike;
- **17% deklarojnë se e kanë vendosur përpara zgjedhjeve** për votën preferenciale të tyre, kategori, e cila pothuajse e njëjtë me pjesën më lart (41%) tregon se 58%, pra shumica e kanë vendosur votën kohë përpara fushatës elektorale ose janë votues të paracaktuar;

- **22% ose rreth një në pesë votues deklararon se vendimin për votën e tij / saj e merr gjatë fushatës elektorale**, tregues i rëndësisë që ka fushata për parti të politike dhe kandidatët;
- Përgjigjet e tjera janë simbolike: në ditën e fundit të fushatës vendosin për votën 6% e të anketuarve, si dhe në konsultim me familjen vendosin 9% e të anketuarve, ku pjesa më e madhe e tyre janë nga kategoria e të rinjve që janë përfshirë në anketim.

## 7. PRIORITETET NË FUNKSION TË MANDATIT ZGJEDHOR 2025-2029

Politika bëhet e vlefshme kur trajton, debaton dhe ofron zgjidhje për problematikat që shqetësojnë qytetarët, ndaj për këtë arsye një pjesë e tretë e anketimit u zhvillua lidhur me prioritetet në pritshmëritë qytetare për 5 vitet e ardhshme. Duke u bazuar në gjetjet e anketimeve të ndryshme të viteve të mëparshme, ISP listoi një listë me prioritete duke ftuar anketuesit të përcaktojnë se cila prej tyre përbën prioritet kryesor me në vijim deri tek prioriteti fundor (prioriteti i pestë).

Nga përgjigjet e marra rezultoi se prioritetet kryesore (prioriteti i parë) për qytetarët janë:

- **modernizimi i sistemit arsimor (56%)**, një tregues i vlerësimit të dijes dhe i pjesëmarrjes masivisht edhe të të rinjve apo prindërve të tyre në anketim;
- **dekriminalizimi i politikës (55%)**, një tregues që lidhet me problematikën vijuese prej 2016 të jetësimit të standardeve të integritetit dhe politikës së pastër;
- **lufta ndaj korrupsionit (50%)**, një tregues i shqetësimit të lartë të qytetarëve ndaj nivelit të lartë të korrupsionit në nivelet e qeverisjes qendrore dhe vendore dhe aspekte të ndryshme të jetës publike dhe shërbimeve sociale;
- **forcimi i shtetit të së drejtës (49%)**, një tregues që vjen në kontekstin e pritshmërive ende të larta për reformën në drejtësi dhe fundin e pandëshkueshmërisë;
- **dobësimi i oligarkëve / ulja e kriminalitetit (47%)**, një tregues që merr vlerë në kontekstin aktual shqiptar, ku akuza se një pakicë kontrollon sistemin politik dhe ekonomik (oligarkë) në mënyrë abuzive dhe korporatave, gjendet gjerësisht në diskursin publik dhe politik.

Të dhënat e detajuara të anketimit japin edhe vlerësimet për prioritetet e dyta, të treta, të katërta dhe të pesta më të rëndësishme, ku respektivisht kryesojnë **reduktimi i emigracionit (32%) si prioritet i dytë, rritja e kulturës qytetare (17%) si prioritet i tretë, investimet në infrastrukturë (22%) si prioritet i katërt dhe investimet në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes (31%) si prioritet i pestë kryesor.**



Interesant është fakti se **opsioni i fokusimit tek anëtarësimi në BE** nuk rezulton në asnjë nga pesë kategoritë prioritare si prioritet i parë, por rezulton prioritet i dytë tek kategoria e katërt e prioriteteve dhe e tretë tek kategoria e pestë e prioriteteve.




Tabela 10\_Prioritetet në funksion të mandatit zgjedhor 2025-2029

## 8. VARIABLA TË PËRGJIGJEVE BAZUAR NË PUNËSIMIN DHE MOSHËN

### 8.1. LIRIA E VOTIMIT, SA MË TË VJETËR AQ MË TË KËNAQUR

Tabela e mëposhtme tregon hendekun midis brezit më të ri dhe atij më të vjetër në vlerësimin e standardeve aktuale të lirisë për të votuar dhe për të zgjedhur. Sa më tepër rritet mosha, aq më tepër rezulton të jetë perceptimi se qytetarët shqiptarë janë të lirë të zgjedhin / votojnë si të duan.

Konkretisht, pjesa e votuesve të vjetër janë dukshëm të bindur se qytetarët janë të lirë të votojnë dhe të zgjedhin: 85% e atyre mbi 65 vjeç, 78% e atyre mbi 55 vjeç dhe 52% e atyre mbi 35 vjeç e konfirmojnë këtë përgjigje. Nga votuesit e rinj (nën 25 vjeç) dominon kategoria “pjesërisht” me 43%, ndërkohë që tek votuesit 45-54 vjeç bën dallim kategoria e vlerësimit se qytetarët nuk janë të lirë për të votuar dhe për të zgjedhur (23%).




Tabela 11\_Liria e votimit

## 8.2. VLERËSIMI I SISTEMIT ZGJEDHOR SIPAS GRUP MOSHAVE

Në analizimin e perceptimit të të anketuarve mbi sistemin zgjedhor aktual bazuar në grup moshat e tyre rezultojnë disa të dhëna me interes. Së pari, perceptimi se sistemi zgjedhor aktual i bën deputetët të varur nga kryetari i partisë ka mbështetje masive tek të gjitha grup moshat e larta (mbi 35 vjeç), pra është një bindje e gjerë qytetare. Mosha midis 55-64 vjeç është edhe më kritike në këtë drejtim, moshë e cila ka edhe përvojën më të madhe me proceset zgjedhore në demokraci.




Tabela 12\_Vlerësimi i sistemit zgjedhor sipas grup moshave

### 8.3. NDIKIMI I MOSHËS NË PREFERENCËN POLITIKE

Të dhënat e marra sipas moshës tregojnë se Shqipëria vijon të mbetet një shoqëri, në të cilën moshën e vjetër ka qasje më konservatore ndaj preferencave elektorale. Ajo thuhet se nuk ndryshon qëndrimin pavarësisht partive, kandidatëve dhe programeve të tyre në zgjedhjet parlamentare dhe lokale. Rreth 60% e moshave 55-64 vjeç dhe 46% të moshave mbi 45% kanë qëndrim të përhershëm preferencial për partinë politike. Brezi i ri ka qasje më pragmatiste dhe liberale, ku rreth 42% e tyre e vendosin votën gjatë fushatës elektorale.




Tabela 13\_Ndikimi i moshës në preferencën politike




Tabela 14\_Dakordësia për të vendosur me ligj kufizim kohor të mandatit të kryetarit të partisë

Qytetarët e të gjitha grupmoshave mbështesin konsiderueshëm kufizimin ligjor të mandatit të kryetarit të partisë. Tendenca rritëse për dakordësi që të vendoset kufizim për mandatin e kryetarit të partive politike nga moshën 18-24 vjeç e arrijnë kulmin në grup moshën 35-45 vjeç. Më pas në grupmoshat e tjera ka një rritje të lehtë të qëndrimit për mos kufizim.




Tabela 15\_Ndalimi i financimit të partive nga burime informale & kriminale

Një prej pyetjeve që ofron thujtë të njëjtën përgjigje është dakordësia e gjerë e të gjithë grupmoshave që reforma në legjislacionin e partive politike të fokusohet në ndalimin e financimit të partive politike nga burime informale si dhe nga ato me bazë kriminale. Në këtë pikë vetëm

votuesit e rinj kanë 55% mbështetje. Pjesa tjetër e votuesve kanë mbështetje më të lartë që arrijnë në 80% tek moshat 55-64 vjeçare. Një shpjegim për këtë mund të jetë fakti se votuesit e rinj e kanë të vështirë ta kuptojnë problematikën që lidh financimin dhe me ndikimin informal të partitë politike, ndërkohë që votuesit më të përvojshëm kanë bindje të krijuar për këtë çështje.


## 9. MBI VOTIMIN DHE NUMËRIMIN E ELEKTRONIK

Përpara anketimit lidhur me prioritetet e reformës zgjedhore dhe të reformës së përfaqësimit ISP zhvilloi një anketim tjetër me pyetje direkte me qytetarët, ku pjesë e tij ishte edhe kapitulli që lidhet me perceptimin qytetar ndaj procesit të votimit dhe numërimit elektronik. Kjo pjesë e anketimit u zhvillua në mënyrë më të thelluar edhe në kuadër të një pune studimore që do të paraqitet në emër të Shqipërisë në një konferencë ndërkombëtare.

Pyetësi përfshiu perceptimin qytetar ndaj përvojës së votimit në zgjedhjet e fundit lokale, si dhe perceptimin e tyre për pritshmëritë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025. Qëllimi ishte ndërlidhja e përvojës me sigurinë dhe standardet e votimit, si dhe nivelin e besimit të qytetarëve votues tek teknologjia, debat që ka rëndësi në periudhën aktuale, kur në kuadër të reformës zgjedhore diskutohet zgjerimi i teknologjisë dhe de politizimi i administrimit zgjedhor.

### 9.1 MBI PËRVOJËN E VOTIMIT NË ZGJEDHJET VENDORE 2023

Pjesa e parë e anketimit lidhej me përvojën e votimit në zgjedhjet vendore, nivelin e informacionit dhe të vështirësive, nivelin e besimit dhe eksperiencën e fituar nga zgjedhësit.



*Tabela 16\_Forma e votimit në zgjedhjet vendore 2023*

Një ndër qëllimet ka qenë përqendrimi i kampionit me peshë më të lartë tek elektorati i cili ka votuar në formë elektronike në zgjedhjet e fundit lokale të 14 Maj 2023, krahasuar me peshën reale që ka pasur kjo pjesë e popullatës në të gjithë Shqipërinë, e cila ka zhvilluar votim në mënyrë tradicionale. Përkatësisht nën fokus kanë qenë qytetet të cilat votuan në formë elektronike Elbasan, Tiranë, Kamëz dhe Vorë. Në këto qytete rezultoi se:

- 25 % kanë votuar në formë elektronike;
- 57% kanë votuar në formë tradicionale.




Tabela 17\_Sa praktik është votimi elektronik?

Perceptimi i përgjithshëm i të anketuarve mbi praktikitetin e votimit elektronik është pozitiv.

- 43% janë të mendimit që është shumë dhe plotësisht praktik;
- 33% janë të mendimit se është në nivelin mesatar praktik;
- Vetëm 11% nuk e mendojnë që ky proces është praktik.




Tabela 18\_Probleme të votimit elektronik

Nëse konsiderojmë identifikimin elektronik nëpërmjet mjeteve identifikuese si Kartë Identiteti ose Pasaportë, treguesit që ky sistem ka funksionuar janë në nivel mbi mesatar 59% dhe vetëm 6% thonë se kanë pasur problem.






Tabela 19\_Siguria në votimin elektronik krahasuar me votimin tradicional me fletë votimi

Siguria e votimit në mënyrë elektronike krahasuar me atë tradicionale rezultojnë të dytoje të anketuarit pasi 20% nuk janë dakord që votimi elektronik është më i sigurt, dhe pothuaj e njëjta masë e vlerëson pozitivisht 23%. Shifër e lartë, pothuaj gjysma e të anketuarve e vlerësojnë në nivel mesatar sigurinë e votimit elektronik krahasuar me atë tradicional.

Këto rezultate janë tregues të qytetarëve jo shumë të sigurt siç duhet të ishte praktikisht mbi sigurinë e votimit elektronik si proces.




Tabela 20\_Informacioni mbi votimin elektronik para zgjedhjeve të 14 Majit 2023

Nga anketimi rezultojnë që niveli i informacionit mbi votimin elektronik para zgjedhjeve të 14 Maj 2023 nuk ka qenë në nivel të ulët, pasi vetëm 16% deklarojnë të kenë pasur informacion dhe 46% nuk kanë pasur fare dhe pak informacion.




Tabela 21\_ Burimet e informacionit mbi votimin elektronik

Format e marrjes së informacionit për votimin elektronik janë media tradicionale 19%, media *online* 28% dhe të dy format e kombinuara në masën 35%.




Tabela 22\_ Interneti si burim informacioni mbi votimin elektronik




Tabela 23\_Pjesëmarrja në zgjedhje

Rezultati i pjesëmarrjes në zgjedhje mbështet tendencën e rezultateve zgjedhore, ku mbi 60% e votuese shkojnë në çdo zgjedhje, 15% preferojnë më tepër zgjedhjet parlamentare, 10% ato lokale dhe 15% preferojnë të abstenojnë.

Zgjedhjet parlamentare, sikurse është praktikë në Shqipëri, kanë pjesëmarrje më të lartë se pjesëmarrja në zgjedhjet lokale.




Tabela 24\_Sa të lumtur ndihen qytetarët nga votimi elektronik?

Kënaqësia nga votimi në mënyrë elektronike nuk rezulton të jetë maksimale sikurse dhe duhet të ishte në periudhën aktuale të zhvillimeve elektronike, pasi 22% nuk marrin aspak ose marrin pak kënaqësi dhe pothuaj e njëjta masë 23% marrin shumë ose plotësisht kënaqësi. Ndërkohë që 38% shprehen për një nivel mesatar kënaqësie.




Tabela 25\_Cila nga format e votimit është më praktike?

Duke krahasuar dy format e votimit tradicionale dhe elektronike sipas kriterit të praktikitetit, rezulton se votimi elektronik perceptohet të jetë 9%-10% më tepër praktik se ai tradicional.




Tabela 26\_Sa janë gati shqiptarët për të votuar në mënyrë elektronike?

Në vijimësi të përgjigjeve të mësipërme, edhe në rastin që pyetjes se aktualisht sa të gatshëm janë shqiptarët për të votuar në mënyrë elektronike, rezulton po e njëjta tendencë, me nivel jo

fort të lartë të gatishmërisë, 18% mendojnë që janë të gatshëm, 30% që nuk janë ose janë pak të gatshëm dhe pothuajse gjysma mendon që janë mesatarisht të gatshëm.




Tabela 27\_Sa besim kanë shqiptarët që vota ruhet dhe numërohet saktë në votimin elektronik vs tradicional

Votimi elektronik rezulton të jetë më i besueshëm në ruajtjen dhe numërimin e saktë të votës krahasuar me votimin tradicional me diferencë në marzhin nga +16% deri në +18%




Tabela 28\_Sa besim kanë shqiptarët në ruajtjen e votës në votimin elektronik vs tradicional

Edhe në rastin e besimit në ruajtjen e fshehtësisë së votës rezultoi besim më i lartë për votimin elektronik sesa ai tradicional me diferencë në marzhin nga +6% deri në +7%.




Tabela 29\_Sa nevojë kanë votuesit për asistencë (ndihmë) nëse votojnë në formë elektronike në qendrën e votimit?

Treguesit e nevojës së votuesve për asistencë, nëse votojnë në formë elektronike janë në nivele të konsiderueshme, pasi 31% mendojnë që kanë shumë nevojë, 8% plotësisht dhe 40% mesatarisht dhe vetëm 14% janë përgjigjur pak dhe aspak.



Tabela 30\_Votimit fizikisht në qendrën e votimit vs votimi nëpërmjet internetit (nga shtëpia, telefoni, me aplikacion, etj.)

Mundësia e votimit nëpërmjet internetit (nga shtëpia, telefoni, me aplikacion, etj.) përveç tipit të votimit fizik në qendrën e votimit mbështetet me 10% më tepër sesa ata të cilët nuk e mbështesin këtë version të votimit. Ndarja midis dy formave të votimit vërehet gjithashtu edhe në ata të cilët janë përgjigjur mesatarisht 26%.



Tabela 31\_Si do të preferonit që të ishin zgjedhjet e ardhme?

Edhe në përgjigjen e pyetjes se si do të preferonin të ishin zgjedhjet e ardhshme nuk rezulton plotësisht mbështetje për zgjedhjen në formën elektronike pasi pak më tepër se gjysma e përgjigjeve e pohojnë këtë formë, ndërsa 28% mbështesin ende formën tradicionale me fletën e votimit.



Tabela 32\_ A është votimi elektronik e ardhmja e zgjedhjeve në Shqipëri?

**Në përfundim, të anketuarit aktualisht nuk rezultojnë plotësisht të bindur që forma e votimit elektronik është e ardhmja e zgjedhjeve në Shqipëri pasi 31% janë dakord, 24% nuk janë dakord dhe 37% janë mesatarisht dakord.**

**Kjo e dhënë vjen ndesh me gjetjet anketimi kombëtar për të njëjtën pyetje, por edhe mund të shpjegohet me faktin se midis dy kategorive, (pakica që e ka aplikuar dhe shumica që e aspirojnë) ka diferenca në vlerësim dhe perceptim. Ata që e kanë aplikuar janë më pak entuziastë sesa ata që nuk e kanë provuar, sjellje qytetare që e gjejmë edhe në pika të veçanta edhe anketime të zhvilluara nga ISP.**